

T'I SHPËTOSH DHUNËS

Tetë histori të patreguara



Ending
Violence
Against
Women



T'I SHPËTOSH DHUNËS

Tetë histori të patreguara

UNDP Shqipëri
"T'i Japim Fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri"

Programi i Përbashkët i OKB-së financuar nga
Qeveria e Suedisë



16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE 2020

Fjalë përshëndetëse nga Limya Eltayeb

Përfqësuese e Përhershme e UNDP Shqipëri

Të nderuar partnerë,

Gratë dhe vajzat në mbarë botën jetojnë nën kërcënimin e dhunës në familje, e dhunës seksuale dhe e dhunës nga partneri intim, nën kërcënimin e përndjekjes dhe të ngacmimit seksual. Dhuna ndaj grave dhe vajzave në të gjitha format e saj mbetet një dhunim i rëndë i të drejtave të njeriut.

“Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën, për dhunën ndaj grave dhe vajzave” më i fundit, i realizuar për Shqipërinë, rikonfirmoi se dhuna ndaj grave dhe vajzave është gjerësisht e përhapur dhe kërkon marrjen e masave të menjëhershme dhe të shumëkahëshme. Kjo merr akoma edhe më tepër vlerë në rrethanat e reja të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, duke ju bërë thirrje të gjithë aktorëve dhe shoqërisë në tërësi që t’i japin fund dhunës tani.

UNDP, në kuadrin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri,” po i ofron mbështetje ofruesve të shërbimeve me qëllim zbatimin me efikasitet të legjislacionit dhe të standardeve normative për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të formave të tjera të diskriminimit. Ndërkohë që pandemia e COVID-19 vijon të përhapet, UNDP nuk

e ka ndërprerë ofrimin e mbështetjes për forcimin e mekanizmave të përgjigjes institucionale kundër dhunës me bazë gjinore, ofrimin e ndihmës për ofruesit shtetërorë të shërbimeve dhe ofruesit e tjerë nga shoqëria civile, me qëllim forcimin e ofrimit të mbështetjes së integruar e të specializuar për viktimat e dhunës në familje dhe të dhunës seksuale.

Sot, në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, ne kemi kënaqësinë të sjellim pranë jush tetë histori të tetë grave guximtare të cilat luftojnë me këtë pandemi, shpesh të padukshme, në çdo ditë e natë të jetës së tyre. Këto histori janë të fuqishme, nga ato histori që të thyejnë zemrën, por edhe frymëzuese gjithashtu. Bashkohuni me ne në fushatën e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore për të ngritur zërin në mbrojtje të të drejtave të grave dhe për një shoqëri pa dhunë. Më lejoni të shfrytëzoj këtë rast për të përshëndetur partneritetin tonë me Qeverinë e Suedisë, e cila ka qenë gjithmonë në mbështetje të punës sonë dhe një aleate e vjetër në mbështetje të fuqizimit të grave, të parimeve të barazisë gjinore, të mosdiskriminimit dhe të eliminimit të dhunës ndaj grave kudo në vend.

Le të bashkohemi në luftën tonë për një shoqëri me të drejta të barabarta për të gjithë, ku gratë ndihen të fuqizuara. Nëse ato ndihen të tilla, shoqëria do të ecë përpara.

Sinqerisht,

Limya

“Minimi i të drejtave të grave është tregues për respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut për shoqërinë në tërësi”

— Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

REZULTATE TË ARRITURA NDËR VITE:

Akomodimi i **217 grave dhe i 334 fëmijëve të tyre** në qendrën e parë kombëtare për të mbijetuarat e dhunës në familje të menaxhuar nga shteti.

Ligjet dhe politikat kanë qenë në përmirësim të vazhdueshëm me qëllim që të garantohet mbrojtja e të drejtave të grave në pajtim me angazhimet dhe standardet ndërkombëtare për çështjet gjinore, të tilla si Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ndihma Juridike Falas, Ligji “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”



Mbështetja e **36 bashkive** për të ngritur dhe për t'i bërë funksionalë Mekanizmat e Koordinuar të Referimit në nivel vendor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje

Përgjatë një viti **62 të mbijetuar/a të dhunës seksuale** kanë përfituar shërbime mbështetëse emergjente të integruara në Qendrën “LILIUM”, e cila është qendra e parë në llojin e saj e menaxhuar nga shteti që ofron shërbime emergjente të integruara ndërsektoriale për viktimat e dhunës seksuale

Sistemi i parë elektronik i menaxhuar nga shteti për regjistrimin dhe gjurmimin e rasteve të dhunës në familje, REVALB, deri më tani ka regjistruar **5785 raste të dhunës në familje**



SI SHPËTUAN 13-VJEÇARI DHE NËNA E TIJ NGA DHUNA NË FAMILJE

M.R është një djalë 13 vjeç, në prag të adoleshencës, moshakurkamëshumënevojëpërmodeleqëfrymëzojnë vetëbesim. Por situata në familjen e tij nuk e ndihmonte shumë në këtë drejtim. Deri pak muaj më parë ai jetonte ne nënën L.R dhe babain Sh.R, në një shtëpi në Patos. Brenda katër mureve kanë ndodhur disa herë skena dhune psikologjike ndaj mamasë 46 vjeçare, e shpesh ai ka qenë prezent. Këto kanë vazhduar për disa muaj, deri kur, një moment mamaja vendosi ta denoncojë bashkëshortin në polici. Për fatin e tyre reagimi ka qenë i shpejtë, duke lajmëruar në kohë edhe koordinatoren vendore kundër dhunës në familje. Pas shqyrtimit të rastit, është arritur në përfundimin se ka rrezikshmëri mesatare, dhe menjëherë është plotësuar kërkesë padia dhe është lëshuar urdhër i menjëhershëm mbrojtje nga gjykata e rrethit gjyqesor Fier.


13 vjeçari me nënën u zhvendosën përkohësisht të gjyshërit në Bashkinë e Urës Vajgurore derisa gjykata

e Fierit aprovoi kërkesë padinë. Projekti “Fuqizimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në bashkinë Patos” finacuar nga PNUD, ndërhyri duke ndihmuar me transport falas nga Patosi në Urë Vajgurore. Në këtë rast djali dhe nëna ishin me fat në çdo hallkë të rrugëtimit të tyre për të shpëtuar nga situata e dhunës në familje pasi institucionet u mirëkoordinuan duke ofuar secili shërbimin e nevojshëm. Nënë e bir u kontrolluan nga Qendra Shëndetësore e Patosit, nëse kishin shqetësime shëndetësore, madje u verifikua dhe familja pritëse, një masë kjo e parë e nevojshme për shkak të situatës që ka krijuar pandemia COVID-19.

Më pas në bashkëpunim me policinë në Patos u bë i mundur shoqërimi i nënës dhe djalit, fillimisht në banesën e tyre për marrjen e sendeve personale dhe më pas për në banesën e prindërve.

Pas vendimit të Gjykatës së Fierit, që urdhëronte largimin e të paditurit nga banesa e përbashkët, në

bashkëpunim me Zyrën Përmbarimore Fier, u bë i mundur ekzekutimi i vendimit dhe kthimi i tyre në banesën në lagjen “Mustafa Matohiti” në Patos.



Sapo u rikthyen në shtëpinë e tyre, Zyra e Punësimit i ofroi nënës një pune ne nje nga këpucaritë e qytetit. Zonja u mbështet me asistencë psikologjike dhe ligjore falas si dhe me paketa ushqimore - nga Bashkia gjatë kohës së pandemisë.

Ndërsa rasti i 13-vjeçarit u referua në Zyrën e Arsimit Parauniversitar, ku shërbimi psiko-social i shkollës ku djali studionte, ofroi mbështetje online.

Kjo mbështetje ishte e domosdoshme për të ndihmuar 13-vjeçarin të tejkalojë rëndesën psikologjike që ka shkaktuar ekspozimi ndaj dhunës në familje. Sipas vrojtimit kombëtar me bazë popullatën “Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri”, fëmijët e rritur në ambiente të tilla nëse nuk mbështeten siç duhet psikologjikisht rrezikojnë krijimin e një personaliteti të ndrojtur ose të tërhequr deri te veprimet agresive me nënën ose me fëmijët e tjerë.



DHUNA / SI U KOORDINUAN 11 INSTITUCIONE PËR TË SHPËTUAR FËMIJET E MITUR DHE NËNËN

M.L. është një nënë me fëmijë të mitur e dhunuar sistematikisht nga bashkëshorti në prani të tyre. Kjo histori zgjati deri sa ajo përfundoi në spital, ndërsa bashkëshorti në qeli. Situata e dhunës në familje ka ardhur duke u rënduar në këto kohë pandemie, sidomos gjatë izolimit brenda shtëpisë kur të dhunuarat dhe dhunuesit ishin të detyruar të shpenzonin më shumë orë bashkë.

Rasti i M.L., për fat të mirë, është një histori suksesi që nisi nga kurajo e nënës për të bërë denoncimin duke vënë në lëvizje një mekanizëm të tërë me 11 aktorë (institucione shtetërore e organizata) për të shpëtuar viktimat e dhunës në familje.

Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje në Has ishte ndër të parat që mësoi rastin dhe asistoi për zgjidhjen e saj. Fillimisht Komisariati i Policisë së Hasit ku u bë denoncimi vlerësoi rrezikun dhe e ndihmoi

nënë të bëjë kërkesë për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje në Gjykatën e Tiranës për arsye sigurie. Vetë nëna u dërgua në spitalin e Hasit për të parë shkallën e lëndimit e për tu kuruar.

Rasti i kësaj familje nuk ishte i lehtë. Një listë e gjatë institucionesh u bashkuan për të ndihmuar. Policia vuri në dispozicion punonjësit e saj në Kukës, në drejtorinë e përgjithshme dhe në komisariatit nr. 5 në Tiranë për t'i zhvendosur fillimisht që ta kishin më të lehtë t'i mbështesnin pa i vënë në rrezik. Nëna e fëmijët u mbështetën jo vetëm nga Bashkia por edhe nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, dhe Qendra Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të dhunës në familje.

Specialistja për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje dhe ekspertja e dhunës në familje në drejtorinë e policisë u angazhuan për të nxjerrë familjen nga ky historik dhune. Ato e shoqëruan në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Nga atje me ndihmën e policëve të komisariatit nr. 5 të Kamzës e shoqëruan për në gjykatë ku nëna kërkonte urdhër të menjëhershëm mbrojtje për atë e për fëmijët. Urdhri u lëshua menjëherë. Me mbështetjen e avokates së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare familja u pajis me Urdhër Mbrojtje ndërkohë

që strehohej në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhuëns në Familje.

Sapo jeta u normalizua disi për nënën që nisi punë dhe regjistroi fëmijët në kopësht dhe në shkollë, ajo bëri kërkesë për zgjidhje martese me kryefamiljarin i cili përfundoi në qeli, fillimisht me masë arresti “burg pa afat” deri sa të përgjigjet për akuzat e dhunës.

M.L, është vetëm një prej grave dhe vajzave që vuan emergjencën e një “pandemie në hije”, sic e kanë etiketuar Kombet e Bashkuara situatën e dhunës ndaj grave e vajzave në kushtet kur Covid-19 ka shtuar sfidat e mbijetesës deri në atë pikë sa shpeshherë adresimi i dhunës në familje konsiderohet si “luks” i tepërt. Në kushtet kur masat e izolimit shtojnë vështirësi për ata që janë përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, është jetike gjetja e mënyrave për t’i informuar këto gra e vajza se institucionet vendore dhe qendrore si këto që janë përmendur në historinë e M.L. janë aty për t’i ofruar shërbime në ndihme të tyre.



HISTORIA E NJË DENONCIMI TË VËSHTIRË

V.D. është një nënë që ka 4 fëmijë, të gjithë të mitur. Bashkëjetesa e tyre me kryefamiljarin ka qenë shumë e vështirë. Të pestë kanë kaluar ditë aspak të lehta ndërsa nëna dhunohej, fëmijët ishin prezent dhe kjo sillte jo vetëm lëndime fizike por edhe pasoja psikologjike të rënda te të gjithë. Fëmijëve kishin vështirësi të përqendroheshin tek mësimet.

Disa herë e dhunuara ka tentuar të reagojë. Rasti i saj ka mbërritur deri te Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje në Bashkinë Klos. Ishte kjo e fundit që e ka informuar për rrugët e mundshme të daljes nga situata, duke e këshilluar të denoncojë rastin në polici. Por kjo nuk ishte e lehtë pasi bashkëshorti e mbante të mbyllur në shtëpi, nën kontroll duke i bërë presion me faktin se as në polici nuk do e përkrahte askush pasi punonjësit ishin miqtë e tij.

Në këto kushte Koordinatorja e mbështeti gruan që ajo të krijonte besim për të kryer denoncimin, jo në Klos por në komisariat nr.5 në Tiranë. Nëna e fëmijët u pajisën me urdhër të menjëhershëm mbrojtje, ndërsa dhunuesi u detyrua të largohet nga banesa.

Ishte policia e Klosit dhe Zyra e Përmbarrimit të

Matit që detyruan dhunuesin të lirojë

mjediset që kishin me qira, ndërsa

nëna për 3 muaj u pajis me urdhër

mbrojtje. Fëmijët u mbeshtetën

me psikologë përgjatë këtyre

muajve që të fitonin qetësinë

e nevojshme për të shijuar

fëmijërinë ndërkohë që iu

rikthyen mësimi në shkollë.

Përparimi i tyre në më-

sime ishte treguesi më

i rëndësishëm i efek-

tit pozitiv që solli


ndërrhyrja e insti-

tucioneve. Gjatë 3

muajve me urdhër


mbrojtje familja u

monitorua, duke u



siguruar që dhunuesi të respektojë masat ndaluese. Gjithashtu, nëna u udhëzua gjithë kohën për hapat që duhet të ndjekë nëse bashkëshorti do të përpiqej t'i lëndonte sërish.

Trajtimi i familjes me bonus qiraje nga Bashkia Klos i ndihmoi të fitojnë normalitetin. Pasja e një mjedisi të sigurtë, inkurajoi nënën të denoncojë dhunën.



TË SHPËTOSH NGA DHUNA HISTORIA E NJË VAJZE TË MITUR

Ajo ishte vetëm 15 vjeçe, kur roja i shkollës ku ndiqte mësimet e abuzoi seksualisht. S.Th përjetoj për një vit rresht abuzimin nga një burrë 60 vjeçar, që për nga mosha mund të ishte babai i saj. Abuzuesi prej kohësh tentonte të përdhunonte të miturën duke e kërcënuar, përndjekur e shantazhuar vazhdimisht dhe në mënyra të ndryshme. E gjendur nën këtë presion, pa i treguar askujt nga rrethi i familjes apo shoqërisë, e mitura pranoi abuzimin dhe heshti.

Por abuzimet me të nuk mbaruan këtu. S.Th përjetoj abuzim seksual edhe nga këta persona të panjohur, të cilët e regjistruan aktin e përdhunimit. Me këtë “provë” në dorë, ata nisën një seri të re kërcënimesh për të miturën. Video rrezikonte të shpërndahej mes personave të tjerë apo në rrjetet sociale.

Pasi hyri në këtë rreth vicioz abuzimesh, kërcënimesh dhe shantazhimesh, e mitura vendosi

të mos heshtë më. Ajo denoncoi rastin në polici, duke treguar për abuzuesit e saj dhe metodat me të cilat ata e shantazhonin. Kaq ka mjaftuar që policia të vinte në dijeni, punonjësen për mbrojtjen e fëmijëve, në zonën ku e mitura jetonte së bashku me familjen.

Specialistët panë që nuk kishte kohë për të humbur. Vajza duhet të merrte menjëherë ndihmën e duhur psikologjike dhe familja e saj mbështetje sociale. Punonjësja e referoi rastin në qendrën Liliun për të marrë shërbimet emergjente që kjo qendër ofron. Shoqërimi i vajzës për në qendër u bë nga punonjësja për mbrojtjen e fëmijëve dhe përfaqësues të organizatës CRCA.

15 vjeçarja ishte përballur me një abuzim të rëndë, ndaj edhe ndërhyrja duhet të ishte e menjëhershme. Vajza mori mbështetje të specializuar psikologjike, që ofrohet në këto raste abuzimesh. Ajo iu nënshtrua një vlerësimi psikiatrik për të parë ndikimin që kishte pasur ngjarja dhe gjithashtu kreu edhe kontrolle e analiza shëndetësore. 15 vjeçarja u akomodua në Qendren Liliun për 48 orët e para, dhe me mbështetjen e vazhdueshme të stafit të përbërë nga psikologë, mjekë dhe infermierë.



Zinxhiri i ndërhyrjes

Raste të abuzimeve të tilla kanë nevojë për një ndërhyrje komplekse dhe afatgjatë. Kjo siguron një rikthim sa më të shpejtë në normalitet të viktimave të dhunës seksuale, por edhe familjeve të tyre. Në këtë mënyrë u veprua edhe në rastin e S. TH. Për të arritur deri tek kombinimi i ndihmës dhe dhënia e saj në shumë plane, është bërë një gërshtim i mirë i punës mes disa ofruesve të shërbimeve publike dhe jo publike.

Puna nisi me vlerësimin e detajuar të rastit dhe ofrimin e shërbimeve emergjente. Personi kyç që ka bërë lidhjen mes vajzës dhe Grupit Teknik Ndërsektorial, si një nga aktorët më të rëndësishëm në menaxhimin e rastit, ka qenë punonjësja për mbrojtjen e fëmijëve. Një pjesë e ndihmës ka qenë edhe ajo që ka ardhur nga organizata joqeveritare, e cila siguroi materialet për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve argëtuese brenda në qendër. Gjithashtu S.Th është referuar edhe tek Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje për Tiranën, duke synuar një koordinim të mirë ndërhyrjesh për trajtimin afatgjatë të rastit.



Shpëtoi nga dhuna. Po më pas?!

Një trajtim efikas i rasteve të abuzimeve seksuale nuk mbaron vetëm më dhënien e ndihmës emergjente. Suksesi qëndron në integrimin e viktimave të kësaj dhune në shoqëri. Ndaj edhe në rastin e 15 vjeçares, zinxhiri i ndihmës u shtri edhe më tej. Ajo u mbështet me strehim të sigurtë dhe në bashkëpunim me Shërbimin Social në Bashkinë Tiranë, u siguroa një banesë e përshtatshme për të gjithë familjen. Pagesa



e qerasë së banesës u mbulua nga bashkëpunimi me disa organizata të shoqërisë civile.

Stafi i qendrës ku vajza qëndroi ditët e para, mbajti kontakte me të edhe pasi u largua nga qendra.

Sot gjendja e vajzës është e qëndrueshme dhe ajo së bashku me familjen po shohin të ecin përpara duke lënë pas krahëve këtë ngjarje.



24 ORËT QË I NDRYSHUAN JETËN VAJZËS SË MITUR

Në datë 11 gusht 2020, në Maternitetin e Shkodrës u paraqit një vajzë e mitur 15-vjeçare, e shoqëruar nga dy burra. Vajza kishte hemoragji e dhimbje. Mjeku e kuptoi menjëherë se me të ishte abuzuar seksualisht. Ngjarja kishte ndodhur po atë ditë dhe u raportua menjëherë në policinë e Malësisë së Madhe pasi u siguroa dëshmia i të miturës. Vajza fillimisht mohoi abuzimin, jo vetëm nga turpi por edhe nga frika. Dy burrat që e kishin shoqëruar ishin babai i saj, dhe xhaxhai. Pikërisht ky i fundit ishte dhe abuzuesi ndaj vajzës. Pa i shkuar ndërmend ky fakt, babai i vajzës i kishte kërkuar të vëllait t'i shoqëronte në spital pasi ai kishte makinë.

Por nga spitali vajza dhe familjarët kanë shkuar në komisaratin e policisë ku janë marrë në pyetje.

I gjendur përballë rrëfimit të vajzës dhe egzaminimit mjekësor xhaxhai rrëfeu krimin dhe u ndalua menjëherë nga policia.

Autori u arrestua...po tani?

Dëmi ishte bërë, vajza e abuzuar e gjeti veten brenda pak orësh nga shtëpia, në spital, në komisariat dhe jashtë tij. Për të evituar kthimin e vajzës në shtëpi pa asnjë mbështetje të specializuar, policia njoftoi menjëherë koordinatoren vendore kundër dhunës në familje në Bashkinë e Malësisë së Madhe, e cila vuri në lëvizje të gjitha institucionet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje. Anëtarët e këtij mekanizmi morën një sërë masash të menjëhershme, duke e shoqëruar të miturën në etapat

e vlerësimit, këshillimit dhe strehimit të sigurt.



Si fillim, u morën masat e duhura që 15-vjeçarja të mos kthehej në shtëpi, por të strehohej te strehëza e emergjencës “Gruaja tek Gruaja” në Shkodër, e cila është pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe atë të Shkodrës.

Psikologia e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në këtë bashki hartoi një plan mbështetjeje, që konsistonte në orë të gjata seancash jo vetëm me të mbijetuarën e dhunës seksuale por edhe me prindërit e saj. Seancat ishin të veçanta për secilin.

Pasojat e abuzimit

Abuzimi seksual tek vajza kishte lënë pasoja jo vetëm në aspektin fizik por edhe atë psikologjik si lëndime, çrregullime të ushqyerjes, e të gjumit, vetëvlerësim të ulët, simptoma depresive, ankth e stres post – traumatik.

Për të mos e kthyer menjëherë në mjedisin familjar ku kishte ndodhur ngjarja, vajza bashkë me nënën u sistemuan në Shkodër. Atyre iu siguarua qiraja për një periudhë dy mujore dhe pako ushqimore nga Bashkia Shkodër, pjesë e një nisme të mbështetur nga UNDP.

Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Bashkinë e Malësisë së Madhe po ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë rast për të dhënë gjithë mbështetjen e specializuar sipas nevojave të të mbijetuarës me qëllim që ajo t'i rikthehet normalitetit së shpejti.





NJË KALVAR ABUZIMESH SEKSUALE QË NGA FËMIJËRIA DHE MBËSHTETJA E SPECIALIZUAR NGA PROFESIONISTËT E VIJËS SË PARË

A.B. është një 26-vjeçare e abuzuar seksualisht që në fëmijëri. Dosja e saj është e mbushur me raste abuzimesh. Dikush e ka përdorur për qëllime seksuale, dikush tjetër për punë të detyruar.

Çdo faqe e kësaj dosje ka lënë gjurmë të thella në jetën e vajzës.

Një ditë, ndërsa jetonte në apartamentin e saj e vetme, pa miq, familjarë, apo të afërm, dy persona të panjohur e dhunojnë seksualisht.

26-vjeçarja denoncon ngjarjen në Komisaratin e Policisë në Tiranë. Pas vlerësimit të rastit të ndërlikuar, për shkak të historikut të gjatë të abuzimeve, e reja u konsiderua si “viktimë trafikimi”. Rasti u referua

pranë Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit në Linzë para kryerjes së intervistës formale dhe u shoqërua në mjediset e kësaj qendre si pasojë e statusit dhe nivelit të rrezikshmërisë.

Ajo i pohon policisë se ndihet e rrezikuar e ka frikë të kthehet në apartamentin e saj. Për këtë arsye, e reja u referua në Qendrën Liliun, për të marrë shërbimet emergjente që kjo qendër ofron për viktimat e dhunës seksuale përmes një ekipi të specializuar multidisiplinar.

Ndihmë emergjente për të mbijetuarën e dhunës seksuale

Sapo u pranua në Qendrën LILIUM, ekipi multidisiplinar hartoi një plan pune. E reja iu nënshtrua ekzaminimit të përgjithshëm shëndetësor dhe atij mjeko-ligjor. Ajo u vlerësua nga një psikiatër dhe u mbështet me shërbime psikologjike nga stafi i Qendrës.

Për katër ditë rresht u strehua në qendrën LILIUM, e shoqëruar me psikolog dhe infermierë, ndërkohë që u mbështet dhe me ushqime dhe veshje.

Stafi i qendrës LILIUM ka mbajtur kontakte me të renë edhe 2 javë pas largimit nga mjediset e tyre me qëllim që të siguroheshin që 26-vjeçarja është mirë

me shëndet dhe ndihej e sigurt. Gjithashtu, e reja u mbështet nga qendra LILIUM për të marrë shërbime psikiatrike të nevojshme.

E reja është një rast përsëritës, e cila është mbështetur më parë dhe nga nga organizata “Të ndryshëm të barabartë”, që sërish u ofrua ta asistojë me medikamente edhe në këtë episod dhune.

Rol kyç në planin e ndërhyrjes ka pasur dhe Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje në Bashkinë e Tiranës, që ka koordinuar gjithë punën për të detajuar planin e ndërhyrjes. Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror është përfshirë me mbështetje përmes takimeve për të vlerësuar të renë me një plan trajtimi afatgjatë.





NJË JETË E RE PËR NËNËN, E MBIJETUAR E DHUNËS, DHE 4 FËMIJËT E SAJ

Për V.D., 45 vjeç janari i vitit 2020 do të mbahet mend si periudha kur i dha fund bashkëjetës në shtëpinë e saj në Fushë- Arrëz, ku dhunohej sistematikisht nga bashkëshorti. Nëse nuk ishte në shtëpi, ai ishte jashtë duke konsumuar alkool për orë e orë të tëra. Sapo kthehej niste keqtrajtimi fizik e psikologjik i gruas. Kjo ndodhi për 22 vite rresht. Katër fëmijë, 19 vjeç, 15 vjeç, 12 vjeç dhe 10 vjeç kishin lindur e ishin rritur në një mjedis ku kishin qenë dëshmitarë të incidenteve të vazhdueshme të dhunës. E para që arriti të distancohej nga shtëpia ishte vajza e madhe, e cila ndjek studimet në Tiranë. Edhe ajo dhunohej e kërcënohej nga babai në gjendje të dehur. V.D kishte tentuar edhe herë të tjera të largohej nga shtëpia, por ishte rikthyer me shpresë se gjërat do të ndryshonin, por dhuna niste sërish, madje incidentet e dhunës u përkeqësuan. Kërcënimet e bashkëshortit, tashmë ndaj vajzës së tyre të madhe i dhanë forcë nënës të hedhë hapin përfundimtar dhe të largohej nga dhunuesi.

Fillimisht nëna me fëmijët u drejtuan komisarariatit në Fushë Arrëz, por atje nuk ia morën denoncimin. Atëherë familja kërkoi ndihmë drejt Tiranës, duke u strehuar tek familja e një shoqes së vajzës së madhe. Gjykata e Tiranës i pajisi me urdhër mbrojtje ndërsa rasti u referua pranë Strehëzës për Gra dhe Vajza nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza. Nga 2020 nëna dhe dy fëmijët 12 dhe 10 vjeç morën shërbim të plotë në Strehëz. Të treve iu dha mbështetje psikologjike për t'i ndihmuar drejt stabilizimit të gjendjes emocionale. Fëmijët u regjistruan në shkollë me ndihmën e Koordinatorës Vendore Kundër Dhunës në Familje të Bashkisë Tiranë. Ata u mbështetën në procesin mësimor me shërbime të vazhdueshme psikologjike, me lojra edukative gjatë kohës së qëndrimit në Strehëz. Ndërkohë, me ndërmjetësimin e punonjësës sociale të Strehëzës, nënës iu gjet një vend pune.

Duke marrë masat për të parandaluar problemet e mundshme, Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të Dhunës në Familje në Bashkinë Fushë Arrëz dhe Policinë ndihmuan me procesin për të siguruar urdhër mbrojtje për 1 vit për nënën, e cila ndërkohë nisi dhe procedurat e divorcit. Në fund të qershorit 2020 nëna finalizoi jo vetëm procedurat e

divorcit, por dhe marrjen e kujdestarisë së tre fëmijëve të mitur.

Pas largimit nga Strehëza familjes iu gjet një banesë me qera dhe u bë i mundur regjistrimi i fëmijëve në shkollë. Duke qenë se gjendja civile është në Pukë, ky proces u ndërmjetësua nga Mekanizimi i Koordinuar i Referimit të Dhunës në Familje në Bashkinë e Tiranës.

Familja u ndihmua për mbulimin e qerasë për dy muaj, paketa ushqimore emergjence për tre muaj, mbështetje me mjete shkollore për fëmijët dhe seanca të vazhdueshme psikologjike me familjen nga Strehëza dhe gjithë institucionet vendore publike dhe jo publike me mbështetjen e UNDP.

Aktualisht nëna dhe fëmijët e saj jetojnë në kryeqytet, punojnë, arsimohen dhe mbështeten në çdo hap nga gjithë strukturat e ngakuara nga ligji.




NGA DHUNUESI NË DHUNUES, DERI SA ERDHI SHPËTIMI

Kur Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje dhe Qendra e emergjencës “Gruaja tek Gruaja” në Shkodër i referoi Strehëzës për Gra dhe Vajza rastin e 30-vjeçares L.L, për të gjithë ishte e qartë që duhej vepruar menjëherë dhe duhej gjetur një zgjidhje afatgjatë.

Gruaja 30-vjeçare në një fshat të Pukës me arsim të mesëm, në vitin 2011 u martua me mblesëri me J.L, banues në Rrëshen, me të cilin ka dy fëmijë, 8 dhe 6 vjeç. Ajo nuk ka qenë asnjëherë e punësuar. Gjithë kohën është marrë me punët e shtëpisë. Ajo ka jetuar në Rrëshen së bashku me bashkëshortin, dy fëmijët dhe prindërit e tij. Problemet në familjen e bashkëshortit kanë lindur që ditët e para të martesës, si mungesë respekti, mospërfillje, neglizhim dhe keqtrajtim jo vetëm nga ana e bashkëshortit por edhe e nënës së tij.

Bashkëshorti ka qenë emigrant në Greqi dhe në periudhat kur vinte pranë familjes, ai ushtronte dhunë fizike, psikologjike dhe ekonomike. Skenat e dhunës



ishin sistematike dhe prania e fëmijëve apo familjarëve të tjerë nuk e bënte të ndalej. Në këtë situatë gruaja është përpjekur të gjejë mbështetje te prindërit, por as ata nuk iu gjendën pranë.

Pa përkrahje, gruaja duroi deri sa një natë bashkëshorti e qëllloi edhe me thikë. Për fat mbijetoi, por e dëshpëruar tentoi t'i japë fund jetës. Pas ngjarjes shkoi të strehohej te prindërit, por as atje nuk ka gjetur shpëtim. Tashmë ishin babai dhe vëllai që ushtronin dhunë fizike e psikologjike ndaj saj. Kur dhuna u bë e padurueshme L.L., denoncoi rastin në polici. Në prani të Koordinatorës Vendore Kundër së Dhunës ajo u shoqërua në Strehëzën e Emergjencës në Shkodër, ku mori ndihmën e menjëhershme.

30-vjeçarja mori strehim e mbështetje psiko-sociale pranë Strehëzës për Gra dhe Vajza. Mekanizmi i Koodinuar i Referimit dhe Koordinatorja kundër Dhunës në Bashkinë e Lezhës ndihmuan që nëna të pajiset me urdhër mbrotje për 1 vit.

Organizata TLAS po ofron shërbime ligjore falas për procedurat e divorcit dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijëve. Tani 30-vjeçarja është regjistruar në Zyrën e Punës në Tiranë në pritje të një pune dhe jete të re. Kur të gjithë profesionistët bëhen bashkë, ka shpresë për të mbijetuarat e dhunës në familje, t'ja nisin një jete pa dhunë.

FAKTE 2020

Shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në nivel vendor

372 **RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE** kanë përfituar nga shërbimet e shumëfishta të ofruara nga

18 **MEKANIZMAT E KOORDINUAR TË REFERIMIT** të rasteve të dhunës në familje, në nivel vendor

301 **RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE** kanë përfituar nga shërbimet psikosociale

Fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të mekanizmave të koordinuar të referimit të dhunës në familje

479 **ANËTARË** të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit dhe ofrues të shërbimeve janë trajnuar mbi zbatimin e ligjit në rastet e dhunës në familje

Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi

73,079 **PERSONA** kanë parë këto fushata në mediat sociale

1475 **PERSONA** kanë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fushatat e ndërgjegjësimit mbi dhunën në familje

Të dhëna të përditësuara në sistemin e gjurmimit online për rastet e dhunës në familje - REVALB

135 **RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE** dhe 3079 përditësime janë regjistruar në sistemin REVALB nga 18 bashkitë e mbështetura nga UNDP

851 **RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE** dhe 10390 përditësime janë regjistruar në sistemin REVALB nga të gjitha bashkitë në mbarë vendin

Qendra LILIUM

3 **GRA**

1 **DJALË**

18 **VAJZA**

22 **RASTE TË DHUNËS SEKSUALE** janë mbështetur përmes shërbimeve të specializuara dhe të integruara të emergjencës

FAKTE: PËRGJIGJA NDAJ SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19

gjinore dhe dhunes ne familje ne nivel vendor

318 RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE kanë përfitur nga shërbimet e shumëfishta të ofruara nga



18 Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, në nivel vendor

245 RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE kanë përfitur nga shërbime psikosociale

2 Është përgatitur protokollin për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19

456 ANËTARË

të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit dhe ofrues të shërbimeve janë trajnuar për përdorimin e këtij protokollin



3 Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi

1307 PERSONA kanë përfitur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fushatat e ndërgjegjësimit mbi dhunën në familje

63695 PERSONA kanë parë këto fushata në mediat sociale



4 Të dhëna të përditësuara në sistemin e gjurmimit online për rastet e dhunës në familje - REVALB

120 RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE

dhe 2323 përditësime janë regjistruar në sistemin REVALB nga 18 bashkitë e mbështetura nga UNDP



729 RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE dhe 8981 përditësime janë regjistruar në sistemin REVALB nga të gjitha bashkitë në mbarë vendin

5 Qendra LILIUM

15 RASTE TË DHUNËS SEKSUALE janë mbështetur përmes shërbimeve të specializuara dhe të integruara të emergjencës

14 GRA DHE VAJZA



* Është përgatitur rregullorja e brendshme e qendrës LILIUM për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë pandemisë COVID-19.

Ky libërth është përgatitur nga UNDP Shqipëri në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pjesë e Programit të Përbashkët të OKB-së “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”, me fondet e Qeverisë së Suedisë

